

VENDIM
Nr.81, datë 12.2.2004

**PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË
SISTEMIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË PRONËSI TË NJËSIVE TË
QEVERISJES VENDORE**

(Ndryshuar me VKM nr. 660, datë 12.9.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10 pika 3.I, 72 pika 5.I shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të neneve 3 shkronja “e” 4, 6 shkronja “a” dhe të nenit 16 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2002 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 1, 2 e 3 që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilave u transferohen pronat e paluajtshme të sistemeve përkatëse të ujësjellës-kanalizimeve, të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktore, kontratat e shërbimit dhe të koncesionit, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, sistemit të ujësjellës-kanalizimeve dhe njësive të qeverisjes vendore me donatorët e huaj dhe shoqëritë kontraktuese.

3. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përfitojnë pronat sipas lidhjeve 1, 2 e 3 të këtij vendimi, janë të detyruara të ruajnë statusin juridik, të paktën për një periudhë 2-vjeçare.

4. Ministria e Ekonomisë të pasqyrojë ndryshimet e kapitaleve që vijnë si rezultat i transferimit të pronave të paluajtshme në njësitë e qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 2 dhe 3. Forma e administrimit për sistemet që transferohen të përcaktohet nga njësitë e qeverisjes vendore.

5. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe njësitë e qeverisjes vendore të kryejnë procedurat e regjistrimit të pronave, të miratuara në këtë vendim.

6. Detyrimet financiare të prapambetura, deri në çastin e transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në njësitë e qeverisjes vendore, të rregullohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

7. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, të pasqyrojë në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore për vitin 2004 fondet përkatëse për pagat, sigurimet shoqërore, subvencionet e investimet buxhetore për pronat e transferuara, duke iu referuar buxheteve përkatëse të viteve të mëparshme dhe akteve ligjore në fuqi.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore dhe donatorët e huaj, për zbatimin e këtij vendimi.

9. Ministritë dhe institucionet qendrore përkatëse të hartojnë udhëzimet e përbashkëta në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja 1

Ndërmarrje të ujësjellësve dhe të kanalizimeve, pronat e paluajtshme shtetërore të të cilave transferohen plotësisht

Nr.	Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësia e qeverisjes vendore në të cilën transferohen	Referenca e miratimit të listave të inventarëve	
				VKM nr.dt.	Lista nr.
1.	Ujësjellës-kanalizime Fushë-Arrëz	Sh.a.	Bashkia Fushë-Arrëz	251 24.4.2003	2
2.	Ujësjellësi Vau i Dejës	Ndërm.	Bashkia Vau i Dejës	251 24.4.2003	15
3.	Ujësjellës-kanalizime, Ersekë	Sh.a.	Bashkia Ersekë	643 18.9.2003	3
4.	Ujësjellësi Novoselë	Ndërm.	Komuna Novoselë	643 18.9.2003	8

Lidhja 2

Ndërmarrje të ujësjellësve dhe të kanalizimeve, pronat e paluajtshme shtetërore të të cilave transferohen plotësisht sipas sistemeve përbërës

Nr.	Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësitë e qeverisjes vendore në të cilat transferohen	Nr.e sistemeve që transferohen	Referenca e miratim.invent.
1.	Ujësjellës kanalizime Pukë	Sh.a.	Bashkia Fushë-Arrëz	Sist. 4.5.6.7	VKM 251 24.4.2003 Lista II
2.	Ujësjellësi Bilisht	Sh.a.	Komuna Qendër Bilisht Komuna Hoçisht	Sist.2.3.4 Sist.5	VKM 366 5.6.2003 Lista 7
3.	<i>Shfuqizuar</i>				

Lidhja nr.3

Ndërmarrje të ujësjellësve dhe të kanalizimeve, pronat e paluajtshme shtetërore të të cilave transferohen vetëm për sistemet përbërëse të identifikuar

Nr.	Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësitë e qeverisjes	Nr.i sistemeve që	Referenca e miratim.invent.
-----	------------------------	-------	----------------------	-------------------	-----------------------------

			vendore në të cilat transferohen	transferohen	
1.	<i>Shfuqizuar</i>				
2.	Ujësjiellësi Përmet	Sh.a.	Komuna Q.Piskovë	Sist.6	VKM 251 24.4.2003 Lista 9
3.	<i>Shfuqizuar</i>				
4.	Ujësjiellësi Vlorë	Sh.a.	Bashkia Selenicë Komuna Kotë	Sist.3	VKM 251 24.4.2003 Lista 16
5.	<i>Shfuqizuar</i>				
6.	<i>Shfuqizuar</i>				
7.	<i>Shfuqizuar</i>				